

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr.76 me objekt “Kundërshtimin e vendimit të KSHZ, nr. 470, datë 03.12.2021, “Për miratimin e raporteve mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura për zgjedhjet e datës 25 prill 2021”, ankuesit: znj.Dasantila Orizaj, znj.Klejda Kuste, z.Fatos Ormenaj, z.Enea Qafa, numërues në KZAZ-në nr.65, Qarku Berat”.


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele (on-line), Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Meta, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** Numërues të KZAZ-së nr. 65: Znj. D. Orizaj,
Znj. K. Kuste, Z. F. Ormenaj, Z. E. Qafa.
Z. Arenc Berati, avokat

OJQ - KRIK

Z. L. Braho: Përshëndetje, sot në datën 12 Janar 2022 çelim seancën publike për shqyrtimin administrativ të Kërkesës Ankimore nr.76, datë 31.12.2021, të paraqitur nga shtetasit: Dasantila Orizaj, Klejda Kuste, Fatos Ormenaj dhe Enea Qafa, të cilët kanë qenë anëtarë të GNV-së që kanë numëruar votat për qendrën e votimit 3305/2 që i përket KZAZ-së nr. 65, Qarku Berat. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me Vendimin nr. 470, datë 03.12.2021 ka miratuar “Raportin mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022**

votimit dhe numërimit elektronik të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”. Në këtë vendimmarrje, ndër të tjera Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur “Miratimin e raportit mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore” sipas Lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pika 4, të bëj kallëzim pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara nga anëtarët e grupeve të numërimit sipas listës në Lidhjen 4, që i bashkëlidhet po këtij vendimi. Në vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndër të tjera arësyetohet se: Nga procesi i këqyrjes paszgjedhore rezultoi se procesi i numërimit të votave për kandidatët e listave shumëmemërore të subjekteve zgjedhore rezultuan se:

3.7 % e QV-ve kanë diferencë 21 - 80 vota (19 QV nga 519 të këqyrura). Për shkak të numrit të subjekteve zgjedhore, numërimit të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore është vlerësuar se marzhi i gabimit nga grupet e numërimit të votave për subjektet nuk kanë ndikuar në ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve. Ndërkohë ndryshimi i rezultateve nga 1-20 vota për kandidatët është vlerësuar se është një marzh i pranueshëm gabimi njerëzor, referuar edhe standardeve teknike për sa kohë këto diferencë nuk kanë ndikuar në ndryshim domethënës të rezultatit për kandidatë. Në total janë 18 QV të cilat kanë diferencë nga 21 – 76 vota për kandidatë ku janë renditur qendrat e votimit, një prej të cilave është dhe QV nr. 3305/2 që i përket KZAZ-së nr. 65 Qarku Berat, që është numëruar nga shtetasit që kanë paraqitur këtë ankim. Ndaj këtij vendimi, në zbatim të nenit 124/1, pika 2 të Kodit Zgjedhor kanë bërë ankim shtetasit e cituar në fillim të kësaj seance. Në zbatim të nenit 12 është hedhur shorti nga ku u caktova unë relator i kësaj çështjeje. Në seancën e datës 10.01.2022 e cila ishte seancë e vërtifikimit paraprak KAS vendosi pranimin pjesërisht për shqyrtim të pikave nga 1 – në 5 të Kërkesës Ankimore nr. 76 dhe mospranimin për shqyrtim të pikës nr.6 të kësaj kërkesë ankimore. Atëherë të bëjmë prezencën e palëve. Për KQZ-në është Sekretari i Përgjithshëm Ylli Merkaj së

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

bashku me nëpunës të KQZ-së. Për palën ankimuese është avokati Arenc Berati dhe dy nga ankimuesit të cilët do të prezantohen sërish.

Z. F. Ormenaj: Fatos Ormenaj, anëtar i GNV të KZAZ-së nr. 65, Berat.

Z. E. Qafa: Enea Qafa, anëtar i GNV-së.


Z. L. Braho: Fatos ke qenë anëtar, apo sekretar?

Z. F. Ormenaj: Sekretar!

Z. L. Braho: Faleminderit dhe zoti Berati që është avokat. Atëherë, zoti Sekretar i Përgjithshëm, në vijim edhe të seancës së kaluar, ju keni paraqitur edhe një sërë provash të reja në seancë që kanë ardhur bashkë me dosjen. Besoj se dhe palës ankimuese i janë vënë në dispozicion, që janë konkretisht: tabela rezultatesh për kandidatët për deputetë të nënshkruara nga GNV-ja në datën 29 Prill 2021. Më tej kemi tabelën e rezultateve për partitë, koalicionet, kandidatët e pavaruar në qendrën e votimit të mbajtur në KQZ në datën 21.05.2021 nga GNV-ja gjatë procesit të ankimimit që është iniciuar nga partitë politike, pas shpalljes së rezultatit zgjedhor. Më tej kemi dhe një tabelë tjetër të rezultateve kjo nuk e ka datën e plotësimit që ka të bëjë me procesin paszgjedhor që është iniciuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të Kodit Zgjedhor, në bazë të të cilit ka dalë dhe vendimi objekt i këtij ankimi.

Z. L. Braho: Ju janë vënë në dispozicion këto prova?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. A. Berati, avokat: Jo!

Z. L. Braho: Jepini një kopje! Atëherë, në pamje të parë pa i dhënë ende fjalën palëve, nga provat rezulton se, të paktën edhe ajo që është objekt shqyrtimi i ankimit administrativ. Ka të bëjë me faktin se nga grupi i numërimit ku ankuesit kanë qenë pjesë, rezulton se në listën e votave të vlefshme për kandidatët për Partinë Socialiste të Shqipërisë, sa i përket zotit Blendi Klosi, nga grupi i numërimit është vlerësuar se ka pas 51 vota të vlefshme gjatë numërimit që është bërë në KZAZ. Ndërkohë nga hapja e kutive gjatë procesit të ankimit, për sa i përket Qarkut Berat, rezulton se kjo qendër votimi është hapur, pra 3305/2, por janë hapur vetëm fletët e votimit. Pra, janë rinumëruar vetëm fletët e votimit për subjektet zgjedhore. Ndërkohë që të vetmet kuti që janë numëruar fletët për kandidat gjatë procesit të ankimit, janë ato që i përkasin KZAZ-së nr. 66, që po ashtu janë të Qarkut Berat dhe janë qendrat e votimit nr. 3324 dhe nr. 3356. Nga procesi paszgjedhor ka rezultuar se nga rinumërimi i votave për kandidatë të Partisë Socialiste, zoti Blendi Klosi nuk ka pas 51 vota sa janë vlerësuar nga anëtarët e GNV-së, por 78 vota ku është dhe kjo diferenca sipas së cilës Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka arësytuar se nuk është gabim njerëzor. Këto janë provat që kemi, besoj se dhe pala ankimuese pikërisht për këto prova ka ngritur dhe pretendimet. Fjala për ju zoti Avokat!

Z. A. Berati, avokat: Shumë faleminderit! U njohëm me dokumentacionin, është pothuajse i njejtë dokumentacion që ne kemi paraqitur së bashku me kërkesën ankimore. Së pari, i qëndrojmë ankimit dhe në mënyrë të përmbledhur kërkojmë t'u paraqesim ju Komisionit, kërkesën tonë ankimore të cilën e kemi mbështetur në dy shtylla. Shtylla e parë kryesore është që të gjitha ankimet administrative të cilat janë kryer përpara fillimit të këqyrjes së fletëve të votimit. Komisioneri Shtetëror i


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Zgjedhjeve, për të bërë të mundur këqyerjen kryesisht të fletëve të votimit, ka nxjerrë një udhëzim. Duke ju referuar këtij udhëzimi ka përcaktuar dhe procedurat, të cilat duhet të ishin ndjekur. Nga këqyerja që ne i kemi bërë dokumentacionit, na rezulton se: ankimuesit janë anëtarë të grupit të numërimit të votave për kandidatët, ka shumë rëndësi fakti, pasi partitë politike i ka numëruar një grup tjetër numërimi. Duke ju referuar dokumentacionit dhe udhëzimit njëkohësisht, duhej që përpara se të fillonte procedura gjykojmë se, duhet të ishin njoftuar ankuesit. Pasi ka filluar një procedim administrativ kryesisht me vullnetin e instuticionit administrativ që është Komisioneri. Duke filluar ky hetim administrativ, ata kanë pas detyrimin ligjor për të përcaktuar drejt se cilët nga subjektet preken nga hetimi administrativ, pasi janë konkretë tashmë. Janë katër numërues të cilët kanë numëruar votat për kandidatët për deputetë. Udhëzimi ka përcaktuar dhe procedurën se si do të vijonte. Duhet ta shpallnin në faqen zyrtare. Ne kemi bërë kërkimet tona, nuk na rezulton që është shpallur për qendrën e votimit nr. 3305/2. Nuk na rezulton as data, as ora. Së dyti, përpara se të paraprihej veprimi administrativ për këqyrjen e materialeve zgjedhore, apo fletëve të votimit, Komisioneri ka përcaktuar me udhëzim në kreun 2, pika 4 “që nuk mund të hapen kutitë të cilat janë numëruar, ose për shkak të veprimeve kryesisht, ose për shkak të kërkesës ankimore të subjekteve”. Pa i përcaktuar këto në pikën 4 nëse janë numëruar votat për subjektet, apo për kandidatët. Udhëzimi këtu nuk e ka përcaktuar, por ka përcaktuar në mënyrë taksative që nuk mund të hapen. Edhe në momentin e hedhjes së shortit, anëtarë të nderuar të Komisionit, nuk është zbatuar pika 9. Në pikën 9 parashikohet që përjashtohen nga renditja qendrat e votimit të këqyera më parë. Unë me të drejtë dua t’i bëj një pyetje përfaqësuesve. Qendra e votimit nr. 3305/2, a është verifikuar? A janë verifikuar të gjitha qendrat e votimit ndaj të cilave ka pas një proces ankimimi, përpara se të hidhej shorti? Ky është një veprim procedural, i cili është urdhërues për kryerjen e mëtejshme të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022**

verifikimit qoftë të materialeve zgjedhore, qoftë të fletëve të votimit. Në këtë kontekst, duke u bazuar në provat që ju keni, por që dhe ne i kemi, na rezulton që qendra e votimit nr. 3305/2, pas një procesi ankimimi, sipas tabelës që ne kemi këtu, rezulton që janë hapur dhe materialet zgjedhore dhe fletët e votimit. Pasi ka pas dhe kontestime për fletët e votimit. Po të shohim shënimin në tabelën e rezultateve që është data e plotësimit 21.05.2021, dy anëtarë të komisionit përkatësisht të subjektit politik LSI dhe PD kanë pasur kontestime për fletët e votimit. Nuk po i futemi analizës, thjesht po ju paraqesim pretendimin tonë që në tabelë është pasqyruar saktësisht që Partia Socialiste, sepse aktualisht objektin e ankimit e kemi për votat e kandidatëve të Partisë Socialiste. Janë përshkruar që janë 150 vota. Vota të vlefshme në total, sipas tabelës janë 336. Nëse do të shohim tabelën për numërimin e subjekteve politike kemi një ndryshim të nderuar anëtarë, në total vota të vlefshme të përgjithshme kanë qenë shkruar 339. Pra, gjatë procesit të verifikimit për shkak të ankimit, ka dalë dhe një korigjim. Pra, do të thotë që ka ndryshuar dhe tabela e rezultatit. Nuk është bërë thjesht një vlerësim përciptazi i kutisë së qendrës së votimit nr. 3305/2. Ajo çfarë të bën të mendosh se kjo kuti nuk duhet të ishte hapur, nga procesi i verifikimit që është bërë paszgjedhor, na rezulton që përsëri janë gjetur 150 fletë votimi në total. Unë këtu përsëri ngre një pyetje! Në momentin që numërohen fletët për subjektin ka dy zarfe. Zarfë Z-06, ku vendosen fletët përkatësisht dhe qartësisht për subjektin dhe zarfë Z-08. Atëherë, sipas të gjitha parashikimeve, se ne nuk kemi marrë pjesë në momentin e rinumërimit të votave të cilat nuk duhet të ishin rinumëruar, na rezulton që për subjektin Partia Socialiste, nuk paska pasur asnjë votë të drejtë për drejtë. Ç'ka do të thotë që këto 150 vota që janë numëruar në momentin e parë, janë vota që i janë nënshtruar vlerësimit, sepse votat ishin si për subjektin edhe për kandidatin. Por, kishte një përjashtim që në zarfën Z-06 duhet të ishin votat përkatësisht dhe qartësisht sipas manualit për subjektin. Përderisa është mbyllur

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.12.01.2022

kutia ne nuk e dimë a ka pasur zarf Z-06 për Partinë Socialiste, apo jo? A ka pasur vota për Partinë Socialiste apo jo qartësisht të përcaktuara? Në këtë kontekst ne vazhdojmë të arësyetojmë se procesi i verifikimit nga Komisioneri me short, është një veprim absolutisht i pavlefshëm, në kontekst të Kodit të Procedurës Administrative. Kjo se vetë Komisioneri ka vendosur që nuk lejohet këqyrja e fletëve të votimit, nëse janë këqyruar më parë. Procesi është i parregullt dhe ka cënuar sigurinë juridike. Kjo përse i përket anës procedurale të kërkuar nga ligji dhe përcaktuar nga vetë Komisioneri. Të nderuar komisionerë, kalojmë edhe te tabela që është plotësuar. Po sipas udhëzimit, tabela është miratuar me Udhëzimin nr.15. Në tabelë duhet të ishte paraqitur përveç të dhënave të cilat janë plotësuar sipas grupit të numërimit i cili duhet të ishte i përbërë prej dy anëtarëve. Në tabelë na rezulton që ne identifikojmë vetëm një anëtar i cili quhet Elvis Beja. Anëtari i dytë nuk identifikohet në tabelën e rezultateve. Çfarë na bën të mendojmë që..., jo të mendojmë por të konstatojmë që kjo është një tabelë e parregullt dhe nuk ka vlerën e provës. Mbi të gjitha, nëse do të shohim përsëri, nuk ka datën kur është plotësuar kjo tabelë. Procesi i kryer vihet në dyshim. Jo vetëm kjo, por nuk ka as numrat e kodeve të kutisë me të cilat mbyllet kutia. Atëherë, a mund të merren të mirëqena i nderuar Komisioner, veprime të tilla në një proces të regullt administrativ? Kur përsëri Komisioneri e ka përcaktuar që duhet të nënshkruhen “emër mbiemër”, të vendoset data, të vendosen kodet e sigurisë në tabelën e miratuar nga ky institucion. Pra, në parimin e hetimit administrativ, i gjithë ky veprim që është kryer për këqyrjen dhe verifikimin e fletëve të votimit për qendrën e votimit nr. 3305/2 është absolutisht i pavlefshëm dhe sipas nenit 117 të Kodit të Procedurës Administrative, nuk mund të sjellë pasoja juridike dhe nuk duhej të parashikohej dhe si shkelje ligjore. Kam dhe një pyetje tjetër, përsëri për institucionin. Në raport është përcaktuar se ka një gabim njerëzor 1-20 që do të quhej gabim njerëzor. Unë dua të pyes a ka ndonjë akt të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

nxjerrë nga Komisioneri, ku të ketë të përcaktuar indikatorët? Pyetja që ka më shumë vlerë është: ky përcaktim kur është bërë? Përpara procesit të numërimit, apo pas procesit të numërimit? Nëse ky përcaktim është bërë pas procesit të numërimit, mua më lind e drejta të dyshoj që gjatë procedurës personat kanë vendosur këto kritere se kanë dashur të ndihmojnë subjekte të tjera. Se çfarë ndryshimi ka 1-20 dhe 21-70? Cili është kriteri që është nisur, sepse nuk shoh që të ketë ndonjë akt të botuar, që të ketë fuqi ligjore për të përcaktuar këto rregulla strikte, sepse nga këto nisemi pastaj tek kallëzimi penal. E gjithë pasoja, e gjithë kjo seancë sot nuk i shërben këtyre, i shërben Komisionerit, që të zhvillojë një proces të rregullt administrativ dhe mos të sjellë pasoja të dëmshme për persona që i kanë numëruar në mënyrë të rregullt fletët e votimit. Nuk ka mundësi që të jenë 150 vota, sepse komisionerët kanë numëruar 122 vota, të cilat kanë qenë për kandidatët. Nuk është treguar në tabelën e rezultateve ku pretendohet për kandidatin për deputet zotin Blendi Klosi, pse ka marrë 78 vota nga rinumërimi? Kujt i janë marrë këto 27 vota që janë më pak, ku i kanë gjetur këto 27 vota që janë më pak? Nuk del, nuk ka këtu shënim të përcaktuar dhe mua më lind e drejta të dyshoj që votat që kanë qenë të përcaktuara drejt për Partinë Socialiste, gjatë procesit të rinumërimit, mund t'i jenë shtuar kandidatit Klosi, sepse ka qenë thjesht një votë e përcaktuar për Partinë Socialiste. Prandaj dhe Komisioneri jo pa qëllim ka vendosur që të mos hapen kutitë për herë të dytë për të mos sjellë një përshtjellim të tillë. Prandaj të nderuar komisionerë, unë gjykoj që të gjitha veprimet janë absolutisht të pavlefshme, përse i përket qendrës së votimit. Qoftë nga ana formale, sepse këtu nuk ka as datën kur është plotësuar, nuk ka as arësyet. Nuk tregohet absolutisht mënyra dhe diferenca se si kanë dalë. Pra, të gjitha veprimet, që të mos biem në përsëritje, janë të pavlefshme dhe si të tilla nuk duhet të pasqyrohen në këtë raport dhe duhet të shfuqizohen. Jo vetëm për faktin se janë absolutisht të pavlefshme, por edhe sepse nuk ekzistojnë. Prandaj mendojmë që të këqyren me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

vëmendje këto materiale. Ne kemi dhe një provë tjetër, të nderuar! Është bërë një fotografim gjatë numërimit të dorëshkrimit të mbajtur për votat dhe pikërisht për Partinë Socialiste rezulton shuma e votave 122, ka qenë ora 02:56 është mbajtur në Pallatin e Kulturës. Mund t'ua paraqesim, është një dorëshkrim i mbajtur nga celulari në momentin kur numëruesit kanë qenë duke kryer punën e tyre, ora 03 e mëngjesit. Kjo provon faktin që 122 vota kanë qenë në total. Nuk ka pas vota të tjera, sepse votat dihehin si ndaheshin. Ndaheshin vota parapëlqyese, që i përcaktoheshin një kandidati dhe vota joparapëlqyese, sepse brenda fletëve të votimit kanë qenë dhe vota që mund të kenë qenë dhe kandidatë më shumë të shënuar në fletë. Nuk ka mundësi të ndodhë që këta me ndërgjegjen e tyre të kenë hequr 27 vota. Ku i kanë çuar? Kujt ia kanë dhënë këto 27 vota? Nuk dihet, sepse të gjithë kandidatët e tjerë janë në rregull. Duke bërë krahasimin e tabelës që këta kanë dorëzuar me atë ç'kanë verifikuar janë të njejta. Këto kisha për momentin. Nuk e di nëse isha i qartë qoftë në procedurë, qoftë dhe për sa kërkojmë. Jam i gatshëm edhe për pyetje.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Berati! Atëherë, administrata e KQZ-së u ngritën një sërë pyetjesh, apo pretendimesh nga përfaqësuesi i ankuesve, besoj se keni ndonjë reagim.

Z. Y. Merkaç: Në lidhje me pyetjen e parë, me sa mbaj mend. Pse është futur kjo qendër votimi nga procesi i ankimimit në procesin e këqyrjes?

Z. L. Braho: Në lidhje me këtë pyetje që ta sqaroj dhe unë. Mund të na e sqaroni pak mënyrën se si është hedhur short më vehte për subjektet dhe short më vehte për kandidatët, apo është hedhur short për qendra votimi dhe pastaj në qendrat e votimit janë numëruar votat dhe për kandidatët dhe për subjektet.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022**

Z. E. Meta: Në bazë të Udhëzimit nr. 15 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, data base e qendrave të votimit ku në krahasim ka qenë përcaktuar vendndodhja, KZAZ-ja dhe qarku e zona zgjedhore, është bërë identifikimi i qendrave të votimit të cilat ishin të sekuestruara dhe ato të cilat ishin të nënshtruara nga procesi i verifikimit në KAS. Referuar këtij udhëzimi, në krahasim ka qenë një kolonë ku shënohej një formulë në excel dhe për të 5199 qendrat e votimit, kjo formulë gjeneronte një numër unik të ndryshueshëm. Për çdo qark, bazuar në parimin e proporcionalitetit të 10% është filtruar informacioni dhe brenda një qarku është zgjedhur numri rendor nga më i madhi deri tek më i vogli në *random*. Kështu është vepruar në çdo qendër votimi duke hequr nga filtri qendrat e votimit të cilat rezultojnë në kolonën “të sekuestruara”, ose “të rishikuara nga KAS-i”.

Z. L. Braho: Po për këtë qendrën nr. 3505/2 kishit bërë shënim, se nga rezultati del që nuk është vënë shënim?

Z. E. Meta: Rezulton që nuk ka qenë shënuar.

Z. L. Braho: Po qendrat e tjera nga ato që janë hapur, se janë hapur goxha në Qarkun Berat dhe Qarkun Durrës?

Z. E. Meta: Kanë qenë, kanë qenë, flas për ato të procesit të rishqyrtimit në KAS.

Z. L. Braho: Pra, vetëm kjo duket që nuk është hequr nga shorti. Ka qenë gabim njerëzor, apo? Po pastaj në momentin që është..., ju i keni hapur edhe për subjektet, apo i keni konstatuar edhe pastaj...

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022**

Z. E. Meta: Këto janë qendra votimi të cilat i nënshtroheshin verifikimit.


Z. L. Braho: Pra, edhe njëherë. Si ky procesverbali këtu, janë numëruar edhe për subjektet sërish qendra e votimit nr. 3305/2?

Z. E. Meta: Po, është parë i gjithë dokumentacioni, është parë në tërësi. Pra, po t'i referohemi procesverbalit të këqyrjes, aty është e gjithë ana dokumentare. Përfshirë Librin e Protokollit të Mbledhjeve, mënyrën e administrimit të dokumentacionit nëse ishin futur nëpër zarfe apo jo. Si të thuash një farë auditimi paszgjedhor për sa i përket performancës së administratës. Njëkohësisht duke qenë se një nga kërkesat e kodit ishte dhe verifikimi i numërimit, është parashikuar e njejta procedurë edhe për verifikimin e saktësisë në numërim.

Z. L. Braho: Dakord! Mund të vazhdoni me pyetjet e tjera.

Z. Y. Merkaç: Në lidhje me plotësimin e tabelës së rezultateve të bëra në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të dyja tabelat e rezultateve të qendrave të votimit nr. 3305/2 janë të firmosura nga të dy anëtarët e stafit të KQZ-së, që janë emëruar nga Komisioneri dhe pavarësisht se tek njëra është vetëm firma dhe jo emër mbiemër. Kjo është pjesë përbërëse e dokumentacionit dhe në fund fare të tabelës kemi një tabelë përmbledhëse e cila është shkruar edhe emri i anëtarit tjetër të grupit të numërimit Alina Hoxhallari. Është faqja e fundit dhe e parafundit e tabelës së rezultateve për subjektet dhe kandidatët. Ajo ka firmosur në të gjitha tabelat. Në lidhje me datën, ne e kemi të regjistruar të gjithë procesin. Është bërë nga data 14 tetor dhe i gjithë procesi është i regjistruar me kamera. Mund të verifikohet,

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

pavarësisht se nuk është shënuar data, regjistrimi është live, në mënyrë të pandërprerë.

Z. L. Braho: Dakord, ka një hark kohor kur është realizuar kjo, por a ka një datë se kur është hartuar ky dokument, kur është nënshkruar ekzaktësisht për këtë qendër votimi?

Z. Y. Merhaj: Brenda këtij afati, por në këtë moment nuk mund t'u japim një datë, duhet ta shohim në kamera.

Z. L. Braho: Duhet të shohim të gjithë procesin që ta gjejmë?

Z. Y. Merhaj: I shohim ne dhe ua japim datën.


Z. L. Braho: Dakord, faleminderit!

Z. Y. Merhaj: Ka qenë një proces në vazhdim, ka filluar me qendrën e parë të Shkodrës dhe ka vazhduar deri në Konispol.

Z. E. Meta: Në datën 15 ka filluar, sipas njoftimit zyrtar publikuar në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë identifikuar qendrat e votimit të cilat do t'i nënshtroheshin verifikimit paszgjedhor dhe është njoftuar që në orën 12:00 fillon procesi i verifikimit. Duke filluar me Bashkinë Shkodër që ishte e para.

Z. L. Braho: Vazhdojmë me pyetjet e tjera!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. Y. Merkaj: Është tabela që keni në dorë që është numëruar nga grupi i numërimit këtu në KQZ për subjektet dhe pastaj për të gjithë kandidatët. Duke qenë se kemi një kuti votimi që kanë të gjitha fletët e votimit, janë shënuar tek faqja e dytë numrat e kodeve të mbylljes së kutisë së votimit, sepse nuk shënohet në çdo faqe., është te faqja e dytë.

Z. L. Braho: Këto janë kodet që presupozohet që sot kanë kutitë?

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. L. Braho: Dakord!

Z. Y. Merkaj: Edhe ky pretendim rrëzohet, nuk qëndron! Nuk e di për pyetje të tjera...

Z. L. Braho: Dy pyetje të tjera. Një pyetje ishte a është shpallur në faqen zyrtare të KQZ-së dita dhe ora se kur do të fillonte këqyrja paszgjedhore? Pyetja tjetër kishte të bënte me aktin për përcaktimin e marzhit të gabimit, pra ajo që arësyetohet në vendimmarrjen e Komisionerit. Këto të dyja kam fiksuar, a ka akt, në qoftë se ka, çfarë date ka?

Z. Y. Merkaj: Atëherë, e gjithë procedura që nga fillimi për shpalljen e shortit, përcaktimin e qendrave të votimit që janë në short, kanë qenë on-line dhe kanë qenë në faqen zyrtare të KQZ-së. Në lidhje me marzhin e gabimit, ne i kemi referuar disa standarteve teknike në të cilin marzhi i gabimit njerëzor është nga 1 deri në 5%. Duke marrë parasysh që tek kjo qendër votimi ka pas 122 fletë votimi të vlefshme

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

dhe 27 nuk janë numëruar, tregon se përqindja është shumë më e lartë se standartet teknike. Duke marrë parasysh këtë standart kemi menduar dhe gjykuar që është bërë me dashje dhe qëllimisht për 27 fletë votimi që nuk janë vlerësuar të vlefshme për një kandidat të Partisë Socialiste.

Z. I. Rusmali: Subjektet zgjedhore kanë marrë pjesë në procedurën tuaj të këqyrjes, e para? E dyta, në qoftë se po, kanë paraqitur vërejtje në dokumentacion?

Z. Y. Merkaj: Sipas Kodit Zgjedhor, këqyrja paszgjedhore bëhet kryesisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ose me ndonjë kërkesë të ndonjë anëtari të subjekteve që kanë pretendime për parregullshmëri të procesit. Ne nga ana jonë e bëmë kryesisht duke marrë parasysh nenin 167/2 të Kodit Zgjedhor, pra është bërë kryesisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Janë thirrur të gjitha partitë pjesëmarrëse në zgjedhje për të marrë pjesë. Kanë marrë pjesë vetëm dy përfaqësues të subjekteve politike, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike të cilët kanë qenë gjithë kohën. Kanë lëvizur lirshëm në të gjitha tavolinat e numërimit dhe kjo mund të provohet edhe me pamjet filmike që i kemi regjistruar dhe i kemi të ruajtura. Partitë e subjekteve të tjera nuk kanë treguar interes dhe nuk janë paraqitur.

Z. I. Rusmali: Kanë bërë vërejtje eventualisht, kanë bërë shënime në dokumentacion në qoftë se kanë pas vërejtje?

Z. Y. Merkaj: Me sa di unë nuk kanë pas vërejtje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. I. Rusmali: Dakord! Ne kemi këtu në dokumentacion tabelën e rezultateve për partitë dhe koalicionet të hartuar nga grupi i numërimit i KQZ-së. Tabelën e hartuar nga grupi i numërimit i KZAZ-së mund ta kemi?

Z. Y. Merkaç: Po është pjesë e provave që ju kemi dorëzuar.

Z. I. Rusmali: Për partitë dhe koalicionet? Për subjektet zgjedhore? Tabelën e ngjashme me këtë, të krahasueshme me këtë.

Z. Y. Merkaç: Nuk jua kemi paraqitur, por mund t'ua paraqesim, nuk ka qenë kërkesa me aq sa mund të mbaj mend unë. Megjithatë, për dy-tre minuta mund t'ua paraqesim.

Z. I. Rusmali: E mira është që ta kemi që të bëjmë këtë krahasim. Tani ju mund të na e analizoni pak fatin e këtyre, sa-ishin 27 votave? Si e analizoni ju gjënë? Diferencë prej 27 votash, i keni parë këto vota, çfarë tregonin këto? Ku ndodheshin këto vota? Ishin në votat e subjektit, s'ishin në votat e subjektit? Ishin të vlefshme, ishin të pavlefshme? Analizën e këtyre 27 votave që bëjnë diferencën, a e bëni dot?

Z. E. Meta: Referuar procesverbaleve bashkëlidhur Udhëzimit nr. 15, në pyetësor pasqyroheshin qartë pyetjet dhe përgjigjet që do të plotësonin grupet e këqyrjes. Për sa i përket plotësimit të tabelës së rezultateve, grupet e këqyrjes kishin për detyrë të shihnin situatën konkrete. Pra, të fotografonin situatën në atë moment dhe kanë pasqyruar atë situatë në atë moment. Pra, janë të gjitha vota të vlefshme, bazuar në atë informacion aty. Bazuar në procesverbalin nr. 1 AZ, aty ka qenë një pyetje që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022**

“janë të sistemuara fletët e votimit në zarf, apo jo?”, pra duhet parë kjo këqyrje tek procesverbali.

Z. Y. Merhaj: Mendoj se duke parë diferencën 150 vota tek subjektet dhe 122 vota që kanë nxjerrë për kandidatët, mendoj që 27 votat janë konsideruar si të pavlefshme nga grupi i numërimit, pavarësisht se nuk janë futur në...

Z. I. Rusmali: Pretendimi nga avokati është që ky grup numërimi i cili nuk ka numëruar votat për subjektet, por ka numëruar vetëm votat preferenciale, nga votat e subjektit Partia Socialiste ka marrë në dorë vetëm 122 vota, jo 150. Këto 122 vota i ka shpërndarë sipas kandidatëve. Në qoftë se shohim tabelën totali është 122 vota dhe shifrat midis kandidatëve rakordojnë. Këtë fakt si e verifikojmë ne, që këta kanë marrë në zarfin e Partisë Socialiste 122 vota, ose këta kanë marrë 150 në fakt dhe kanë numëruar 122. Këtë si do ta gjejmë ne?

Z. Y. Merhaj: Kjo është lehtësisht e verifikueshme pasi grupi i numërimit të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka hapur kutitë të cilat janë dorëzuar nga KZAZ-ja nr. 65. Këto vota janë gjetur tek kutia, ndoshta jo tek zarfi i partisë por janë gjetur tek kutia dhe janë vota të Partisë Socialiste.

Z. I. Rusmali: Grupi i numërimit të KQZ-së në procedurën ankimore ka bërë rivlerësim të ri të votave.

Z. Y. Merhaj: Vetëm për subjektet...

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*


Z. I. Rusmali: Po dakord! Ekziston versioni që në VNV janë numëruar votat herën e parë dhe subjektit i janë dhënë 122 dhe kur ka ardhur në procedurë ankimore është bërë rivlerësimi i votave dhe subjektit i janë dhënë 150. Ekziston ky skenar?

Z. Y. Merkaj: Jo nuk ekziston pasi nga tabela e rezultateve të numëruara nga GNV-ja e KZAZ-së janë 150 vota për Partinë Socialiste. Edhe gjatë procesit të ankimit janë 150 vota. Dmth rezultati i dalë nga tabela e rezultateve të KZAZ-së në procesin e ankimit është i njëjtë me rezultatin e plotësuar nga grupi i numërimit emëruar nga KQZ-ja, është identike dhe tabela.

Z. I. Rusmali: Avokat, do ta kthejmë tek ju pyetjen tani, sepse nga KQZ-ja na jepet ky lexim i votave dhe i verifikueshëm besoj, do të na vijë ne tabela, për punë minutash dhe ne do ta kuptojmë. Keni lexim tjetër ju?

Z. A. Berati, avokat: I nderuar Anëtar, problemi qëndron këtu, sepse procesi ka qenë i ndarë. Tjetër grup numërimi, por ka një moment të diskutueshëm këtu që është i dyshimtë. Ka një zarf Z-06 që futeshin votat vetëm të shënuara për partinë. Atëherë, kush më siguron mua që kur është hapur nuk janë shtuar votat zotit Klosi, sepse nuk ka mundësi... ne kemi bërë një analize të 74 qendrave të votimit të Beratit për subjektin Partia Socialiste. I gjithë problemi është, zotërinjtë kanë numëruar 122 vota, nuk kanë numëruar më shumë se 122 vota. Votat e tjera mundet që të jenë vetëm për subjektin, diferenca. Se nuk ka mundësi, të gjitha qendrat e votimit kështu dalin, nuk del vetëm kjo qendër votimi. Pra, vota të vlefshme për Partinë Socialiste janë 150, vota të vlefshme të përcaktuara parapëlqyese janë 122 dhe pjesa tjetër mendoj unë, sepse nuk i kemi parë votat, prej 27 votash mund të jetë Partia Socialiste. Mund të kenë qenë 1, 2, 3 kandidatë, të cilat nuk vlerësoheshin votë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.12.01.2022

parapëlqyese, por vlerësoheshin votë për subjektin. Këto vota nuk futeshin tek zarfi Z-06. Te zarfi Z-06 futeshin vetëm vota që përcaktonin subjektin në anën ku ishte numëri i subjektit. Këto vota nuk i kanë numëruar këta. Këta kanë numëruar vetëm votat për kandidatët.

Z. I. Rusmali: Në tabelën që kanë nënshkruar të përfaqësuarit prej jush, ka një kollonë në krye që thotë “vota të vlefshme gjithsej për subjektin”, e cila nuk është plotësuar nga të përfaqësuarit prej jush. Në fakt duhet të ishte plotësuar.

Z. A. Berati, avokat: Shumë e saktë, kjo do parë te zarfi, sepse vetë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, apo vetë Komisioneri, në momentin kur janë paraqitur dhe komisionerët kanë kërkuar të mbushin këtë tabelë, i kanë thënë “zarfi Z-06 nuk hapet dhe ju do ta lini bosh”, sepse këta nuk mund të vendosnin një numër të subjektit kur nuk e kishin numëruar. Kjo duhet të ishte bërë nga komisionerët e mëparshëm, ose këta duhet të ishin në vazhdimësi. Më kujtoni zoti Komisioner? Pra zarfi Z-06..


Z. I. Rusmali: Çfarë do të thotë që “nuk hapet zarfi Z-06”?

Z. A. Berati, avokat: Po këtyre u është thënë, sepse fillimi i procedurës së numërimit të votave...

Z. L. Braho: Me sa mbaj mend unë nga procedura, ishte zarf më vehte. Pra, kur hapeshin votat për subjektet, pra që numëroheshin për subjektet, ato vota që nuk kishin një kandidat preferencial futeshin në një zarf më vete dhe këto nuk hapeshin më nga grupi i numërimit kur numëronin votat për kandidatët preferencialë. Kishte një zarf më vete që kishte kandidatët preferencialë.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. I. Rusmali: Vota vetëm të subjektit nuk janë 150, nuk mund të jenë?!

Z. A. Berati, avokat: Jo nuk mund të jenë!

Z. I. Rusmali: Tani zarfi që futen vetëm votat e subjektit të gjitha...

Z. A. Berati, avokat: Nuk futeshin në zarf të gjitha. Futeshin ... supozojmë, po ngre një supozim për të sqaruar situatën, sepse as unë nuk e di. Supozoj që 27 vota mund të kenë qenë vota vetëm për subjektin, janë mbyllur te zarfi Z-06 dhe ky zarfi Z-06 nuk hapet më. Ja ku është manuali këtu.

Z. I. Rusmali: Dakord, po ky zarf me të gjithë votat e tjera të subjektit ku shkojnë?

Z. A. Berati, avokat: Te zarfi Z-08.

Z. I. Rusmali: Te zarfi Z-08 shkruhet 150, e morën këta?

Z. A. Berati, avokat: E morën! Kanë gjetur zarfin Z-06 që nuk hapet, kanë gjetur dhe 122 vota., mund të jenë 122, ose këta kanë nxjerrë që nuk ka qenë votë parapëlqyese. Dy mundësi ka! Nuk ka të tjera! Prandaj me të drejtë ngrihet pyetja, ka pas ndonjë zarf Z-06 për Partinë Socialiste dhe sa ka qenë kjo? Sepse ato shënoheshin sipër zarfit dhe firmoseshin.

Z. I. Rusmali: Dakord! Ka pas zarf Z-06 për Partinë Socialiste?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. Y. Merkaj: Po për të gjitha subjektet.

Z. I. Rusmali: Në zarfin Z-06 që ju e keni hapur në këqyrje, ju rezultojnë 27 vota për kandidatin?

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. I. Rusmali: E saktë, kjo do të thotë...

Z. A. Berati, avokat: Që i kanë numëruar të tjerët!

Z. I. Rusmali: Kjo do të thotë që sipas procedurës nuk mund të jenë këta përgjegjës për këtë.

Z. A. Berati, avokat: Shumë e saktë!

Z. L. Braho: Edhe njëherë që ta kuptoj, ka pas një zarf ku ishin 27 vota vetëm për subjektin?

Z. Y. Merkaj: Tani, unë nuk mund të them për këtë qendër votimi, unë po them procedurën që është ndjekur. Numërohen votat për subjektet dhe futen në zarf më vehte dhe votat preferenciale lihen më vehte.

Z. L. Braho: Me sa di unë nga procedura, grupi i numërimit që hapte votat preferenciale nuk i prekte më zarfet ku ishin votat për subjektet. Pra, mundet që ky grup të ketë marrë vetëm një zarf me 122 vota? Është e mundur?

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. Y. Merkaj: Po, mundet!

(Pa mikrofon)

Z. Y. Merkaj: Më fal, kjo është një procedurë që nuk mund t'i përgjigjem unë. Ne si KQZ i kemi çuar, se çfarë kanë bërë ata se si dhe ku i kanë futur, ne nuk mund të japim përgjigje. Unë i kam çuar Z-06, Z-07, Z-08 ajo është përgjegjësi e tyre se ku i fusin dhe se si i fusin votat. Unë kam bërë trajnim dhe u kam thënë që tek Z-06 do të futen votat për subjektet, tek Z-08 do të futen për kandidatët..., kaq është detyra ime ka mbaruar. Se si e zbatojnë trajnimin që i kam bërë unë dhe kodin është tjetër gjë.

Z. I. Rusmali: Jo nuk po them..., po them që në qoftë se ju e keni të dokumentuar gjatë këqyrjes. Keni bërë këqyrjen pas, në qoftë se e keni të dokumentuar dhe e nxirrni nga dokumentacioni që keni ju, saktësisht si ka ndodhur. Ajo që thoni ju mund të ketë ndodhur dhe kështu është relative, nuk është se nuk na ndihmon, na ndihmon ne për të marrë vendimin tonë. Por, në qoftë se ju keni mundësi të na jepni përgjigjen me saktësi është mirë për këtë procedurë. Në qoftë se nuk e keni mundësinë të na e jepni përgjigjen me saktësi s'ka asnjë problem. Ne vazhdojmë edhe me këtë lloj fjalie. E keni, apo se keni? A mund të bëjmë 5 minuta pushim, të bëjë një verifikim administrata dhe pastaj vazhdojmë.

Z. L. Braho: Atëherë, seanca pezullohet për një pushim 5 minuta sa të bëhet një verifikim nga administrata e KQZ-së në lidhje me këtë qendër votimi, rikthehemi pas 5 minutash.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.12.01.2022

Rifillon seanca

Ora 13:10

Z. L. Braho: Atëherë, riçelet seanca e shqyrtimit administrativ të Kërkesës Ankimore nr. 76, dt.31.12.2021. Nga administrata e KQZ-së na u vu në dispozicion tabela e rezultateve për partitë politike, koalicionet, kandidatët e pavarur të qendrës së votimit për Qarkun Berat, KZAZ-ja nr. 65, mbajtur nga grupi i numërimit nr. 3, për qendrën e votimit nr. 3305/2, datë 26.04.2021, ku është përcaktuar shpërndarja e votave të vlefshme për subjektet zgjedhore për këtë qendër votimi. Nga ky akt administrativ, rezulton se grupi i numërimit që ka numëruar fletët për subjektet zgjedhore është i ndryshëm nga grupi i numërimit që ka numëruar fletët për votat e kandidatëve, pra që ka të bëjë me një nga pretendimet që ngriti pala ankimuese. Po zoti Sekretar i Përgjithshëm!

Z. Y. Merkaj: Përpara procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, administrata e KQZ ka përgatitur një tabelë të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me disa pyetje të cilat është menduar nga administrata që do të jenë problematike dhe do të dalin gjatë procesit të këqyrjes paszgjedhore. Në faqen e parafundit të kësaj table., është e ndarë në dy pjesë faqja e fundit ku në krahun e djathtë është një pikë ku thuhet “a janë futur fletët e votimit në zarf sipas subjekteve zgjedhore?”. Kjo është e plotësuar “Po”! Grupi i numërimit i caktuar nga KQZ-ja këtë ka bërë, ka parë nëse janë futur fletët e votimit. Ç’ka do të thotë...

Z. L. Braho: Ky proces i referohet futjes së fletëve të votimit pasi janë hapur në KQZ gjatë procesit të rishqyrtimit të ankimit në KAS, apo jo?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. Y. Merkaj: Po, pra ka rezultuar që këto janë në zarfën e subjekteve zgjedhore, që do të thotë, në qoftë se do të ishin fletë votimi jashtë zarfit të subjekteve zgjedhore do të shkruhej që “ka një parregullësi” në këtë rreshtin këtu ku mund të shënohej. Përderisa nuk është shënuar, presupozohet që kanë qenë në zarfën e subjekteve zgjedhore. Gjithashtu duke marrë parasysh këtë tipologji dhe këtë problematikë, duke parë tabelën e rezultateve për subjektet zgjedhore, rezulton se vota të pavlefshme janë 21 vota. Në fund tek faqja e dytë që po flasim është gjetur dhe tipologjia dhe problematika pse janë këto 21 fletë votimi të pavlefshme dhe nga natyra pse janë nxjerrë të pavlefshme. 11 fletë votimi janë nxjerrë të pavlefshme pasi është votuar për më shumë se dy subjekte zgjedhore. 10 fletë votimi janë nxjerrë të pavlefshme pasi është votuar për një subjekt zgjedhor dhe një kandidat të një subjekti tjetër zgjedhor. Deri këtu ka arritur këqyrja dhe të vlerësuarit të dokumentacionit.

Z. L. Braho: Pala ankuese, ka ndonjë gjë tjetër?

Z. A. Berati, avokat: Po, po patjetër. Pyetjes tonë nëse ka pasur zarf Z-06 nuk ju përgjigj. Duke marrë në konsideratë raportin që kanë plotësuar do të thotë që ka pas zarf Z-06. Këtu thotë “Po, futur sipas zarfave”. Pyetja ime është sa vota të subjektit Partia Socialiste janë gjetur në zarfën Z-06 nga këqyerja juaj? Tani këtu do të shkojmë nuk ka rrugë tjetër?

Z. Y. Merkaj: Unë do t’i përgjigjem pyetjes vetëm me kaq që “zarfe Z-06 i janë shpërndarë të gjitha KZAZ-ve, sipas qendrave të votimit”. Kaq mund të them! Se si janë futur, se sa janë futur është pjesë e grupit të numërimit pastaj.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. I. Rusmali: Këqyrja ndodh pas procedurës së ankimimit për këtë qendër votimi. Do të thotë që këqyrja reflekton situatën siç është lënë nga grupi i numërimit të KQZ-së, jo nga grupi i numërimit të KZAZ-së, apo jo? Dakord!

Z. A. Berati, avokat: Kam dhe një pyetje tjetër. Unë dua të di, cili ka qenë qëllimi që Komisioneri ka përcaktuar në pikën 4 “nuk lejohet këqyerja e fletëve të votimit, ose materialeve zgjedhore që është këqyruar më parë kryesisht, ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore përgjatë procesit të ankimimit”. Pse është vendosur ky ndalim?

Z. Y. Merkaç: Është vendosur ky ndalim që të mos ketë përsëritje, por në rastin tonë nuk ka përsëritje pasi nuk është i njejti objekt dhe nuk është i njejti shkak, sepse nuk janë numëruar fletët e kandidatëve, por vetëm të subjekteve.

Z. A. Berati, avokat: Nuk dua të bëj interpretim të dispozitës, por dispozita këtu nuk e urdhëron të subjekteve, apo të kandidatëve.

Z. I. Rusmali: Të lutem Avokat, ne po të dëgjojmë me shumë vëmendje. Në qoftë se qëllon që nuk reagojmë nuk do të thotë që se kemi mendjen. Nuk ka nevojë të na e thuash në mënyrë të përsëritur një analizë.

Z. A. Berati, avokat: Kam dhe një pyetje tjetër të lutem! Në tabelën e rezultatit paszgjedhor, pavarësisht se nuk janë të identifikuar as datat, ka një korigjim tek kandidati Blendi Klosi në tabelë dhe ju mund ta shihni. A mund të më thoni, janë 147 vota që ju keni nxjerrë, ndërkohë që të dhënat sipas verifikimit tuaj janë përsëri 150. Pse është ky ndryshim? Po në këtë tabelë. Pra, kjo tabelë vazhdon të ketë probleme.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. Y. Merkaj: Ne kemi pasqyruar çfarë kemi gjetur tek kutia e votimit, i kemi qëndruar me rigorozitet çfarë është gjetur në kutinë e votimit.

Z. L. Braho: Ylli, pyetja e Avokatit, të paktën siç e kuptoj unë për këtë tabelën paszgjedhore. Pra, thotë “vota të vlefshme gjithësej për subjektin 150”. Ndërkohë tek shperndarja e votave për kandidatin dalin 147. Unë e kuptoj që këtu janë tre vota tek zarfi Z-06. Pra, që janë vetëm për subjekt pa kandidat. Mund të interpretohet kështu?

Z. Y. Merkaj: Jo! Këto janë tre vota të pavlefshme mendoj unë dhe nuk ka pas rubrikë që ai të shënojë “vota të pavlefshme”. Ka pas vetëm për vota të vlefshme, prandaj nuk është shënuar.

Z. L. Braho: Kjo përputhet dhe me faqen e parë të materialit që thotë “Partia Socialiste e Shqipërisë, numri votave të vlefshme pas verifikimit 150”. Unë kështu e kuptoj, nuk di nëse ka ndonjë interpretim tjetër. I bie që janë tre vota për Partinë Socialiste kur nuk është përzgjedhur për asnjë kandidat preferencial.

Z. I. Rusmali: Unë kam përshtypjen se kjo nuk ka lidhje më me objektin e ankimit, besoj unë. Si tabela për subjektet në këtë rast dhe tabela për kandidatët është plotësuar nga të njëjtët persona. Janë të njëjtët njerëz që kanë bërë vlerësimin, të njëjtët që te subjektet kanë shkruar 150, të njëjtët tek totali i votave preferenciale kanë shkruar 147. Kjo çfarëdo që të jetë është një gjë që nuk ka lidhje më me procesin, mendoj se nuk ja vlen që ne ta eksplorojmë më tutje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. A. Berati, avokat: Unë mendoj se këtu nuk identifikohen të dy personat i nderuar Komisioner. Identifikimi është sipas formularit, emër, mbiemër, firmë. Jo pa qëllim e ka miratuar udhëzimi.

Z. I. Rusmali: Ky është argument që ne e dëgjuam. Ne kemi konfirmimin nga administrata e KQZ-së që këta janë të njëjtët persona që kanë plotësuar dokumentacionin. Konfirmimi që na vjen është i besueshëm dhe i pranueshëm për ne. Kjo nuk ka lidhje me çështjen. Nuk ja vlen të bëjmë debat këtu, por për aq sa bëhet debat për këto 2-3 vota që janë plotësuar në tabelë nga të njëjtët njerëz, kjo kërkon një hetim që nuk ka lidhje më me procesin tuaj. Për çfarë duhet ta bëjmë?

Z. A. Berati, avokat: Jo, ideja gjithmonë që procesi këtu është i pavlefshëm në veprimet administrative, prandaj vijnë të gjitha këto pasojat sot.

Z. L. Braho: Atëherë Avokat, si përfundim ju kërkonti?

Z. A. Berati, avokat: Dakord! Do të dëshiroja të dorëzoja dhe një provë tjetër pavarësisht se ju do ta merrni të mirëqenë apo jo. Kam një fotografim të orës 02:56 ku komisioni ka përpiluar numërin e votave për çdo subjekt me shkrim dore për efekt llogarie dhe për Partinë Socialiste ka vendosur dhe numërat përkatës të votave sipas renditjes në fletën e votimit ku totali i kësaj shume në orën 02:56 është 122. Janë dhe për subjektet e tjera, por meqenëse jemi në procesin e...

Z. I. Rusmali: Dakord, sille ta shohim! Shihe Ylli njëherë!

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. Y. Merkaç: Një letër që është mbajtur nga ndonjë kandidat, apo përfaqësues partie që për ne nuk ka asnjë vlerë. As firmë, as vulë, as emra, as kush e ka mbajtur këtë shënim.

Z. L. Braho: Në lidhje me provën do të shprehemi së bashku me vendimin. Zoti Berati, ndonjë gjë tjetër? Në qoftë se nuk keni gjë tjetër, vazhdojmë me konkluzionet përfundimtare, përmbledhtazi se ne jemi të qartë për çfarë kërkon ju.

Z. A. Berati, avokat: Faleminderit! Unë do të mendoja meqenëse arritëm në këtë debat, se ka goxha debat, të kryhej hetimi administrativ nga KAS-i për këtë kuti 3305/2 për 150 votat.

Z. L. Braho: Konkretisht, çfarë nënkupton me këtë?

Z. A. Berati, avokat: Të shihet, të hapet materiali dhe të shihet ka zarf Z-06, ka vota preferenciale dhe sa vota janë vetëm për subjektin Partia Socialiste? E kemi shprehur edhe në kërkimin tonë.

Z. L. Braho: Administrata e KQZ-së çfarë mendimi ka në lidhje me këtë kërkesë të ankuesit?

Z. Y. Merkaç: Unë mendoj se për sa kohë ky vë në dyshim gjithë besimin tek KQZ-ja duke thënë që “ju gjatë numërimit i keni marrë votat dhe i keni shënuar një kryq tek kandidati”, për mua s’ka asnjë vlerë.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.12.01.2022

Z. L. Braho: Nuk është vetëm ky aludim, njëri nga aludimet mund të jetë ky se dhe unë kështu e kuptova, por një aludim tjetër ishte që dhe këto 22-23 fletë nga grupi i numërimit që ka numëruar votat për subjektet mund të jetë futur edhe gabimisht tek zarfi Z-06 dhe këta numërues nuk i kanë pas në dispozicion për t'i numëruar ato vota. Pra, nuk është vetëm aludimi që kjo është bërë e qëllimshme se dikush ka mbushur fletët e votimi në favor të një kandidati. Janë këto dy pretendime që ngrihen. Ky i dyti ishte i mundur edhe nga pyetja që bëmë ne. Ishte i mundur edhe teorikisht dhe ju e pranuat që dhe mund të ketë ndodhur.

Z. Y. Merkaç: Mendoj që u ngrit pretendim tjetër, u tha që nuk ka zarf Z-06. Unë ju them që zarfi Z-06 është shpërndarë në të gjitha KZAZ-të.

Z. L. Braho: Nuk është ideja zarf bosh, ideja është të verifikojmë nëse ka një shënim tek zarfi Z-06.

Z. Y. Merkaç: Unë i kam dërguar zarfin Z-06, se ti nuk e ke futur për paaftësinë tënde aty, nuk është pjesa ime. Megjithatë, unë mendoj se këta katër persona kanë shkuar në prokurorinë e Beratit dhe ka filluar procedimi penal dhe për këta. Kështuqë mund të jetë dhe pjesë e hetimit që mund ta pretendojnë, në qoftë se nuk janë këta fajtorët.

Z. I. Rusmali: Kutia që ju kërkoni të hapet e të shqyrtohet, nuk është më produkt i punës së të përfaqësuarëve prej jush. Është produkt i punës së disa personave të tjerë që kanë ardhur pas tyre. Nëse ne e hapim, e shohim dhe këqyrim ekziston, është apo jo zarfi Z-06 brenda, kushdo qoftë përgjigja, ka lidhje me katër numërues të tjerë, të cilët e kanë plotësuar rregullisht sipas udhëzimeve dhe mbushur këtë zarf, ose nuk e kanë mbushur këtë zarf sipas udhëzimeve. Ne në qoftë se hapim kutinë, nuk gjejmë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Dt.12.01.2022

asgjë që ka lidhje me ju. Në këtë logjikë, në qoftë se ju e kërkon, ne duhet t'u japim përgjigje dhe duhet ta hapim menjëherë, por nuk i shërben as qëllimeve tuaja dhe as qëllimeve të procesit.

Z. A. Berati, avokat: Qëllimeve të procesit i shërben për të treguar se si procedon Komisioneri në çështjet kryesisht. Kjo ka shumë vlerë për të dalë e vërteta.

Z. I. Rusmali: Ne nuk jemi duke shqyrtuar punën e Komisionerit, ne jemi duke shqyrtuar një çështje që është shumë konkrete.

Z. A. Berati, avokat: E kuptoj, por kjo çështje konkrete i Nderuar, lidhet patjetër me procedurën, faleminderit!

Z. L. Braho: Një pyetje për administratën. Në qoftë se te zarfi Z-06 futen "x" numër fletash, mbi zarf shënohet numëri i fletëve? Ka ndonjë shënim apo thjesht Partia Socialiste...

Z. Y. Merkaç: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe konkretisht Komisioni Rregullator, kanë miratuar modelet e zarfeve mbi të cilët janë shënuar "zarf për subjektet zgjedhore", "zarf për kandidatët e subjekteve zgjedhore". Kaq shënohet, pjesa tjetër ka disa anëtarë të grupeve të numërimit që mund ta shënojnë numërin në zarf e disa jo. Por, udhëzim që të shënohet numri i fletëve të votimit në zarf, nuk ka! Ai plotësohet zakonisht me dorë, sepse është çështje fakti, se sa fletë votimi ka. Nuk mund të përcaktohet nga Komisioni Qendror.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

Z. L. Braho: KAS vendos të rrëzojë kërkesën për hetim të thelluar, për riçeljen e hetimit në lidhje me kutinë e votimit ku janë materialet zgjedhore dhe fletët e votimit për këtë qendër votimi. Ftojme palën për pretendimet përfundimtare.

Z. A. Berati, avokat: Faleminderit! Në mënyrë të përmbledhur, përpara jush u provua sot, vetë pala Komisioneri pranoi që nuk e ka zbatuar procedurën. Pranoi që nuk e ka përjashtuar nga shorti qendrën e votimit nr. 3305/2, e cila është rinumëruar. Nga ky hetim u provua fare qartë që të gjitha veprimet proceduriale të kryera administrative janë në kundërshtim flagrant me Udhëzimin nr. 15, kreu 2, pika 4, 9 dhe si të tilla nuk mund të sjellin pasojë juridike për sa i përket qendrës së votimit nr. 3305/2. Konstatimet e tyre më pas nuk duhet të pasqyrohen në raportin për të cilën janë shprehur që e ka miratuar Komisioneri. Në thelb, unë kërkoj të pranohet ankimi që kemi paraqitur sipas objektit duke përjashtuar atë pikën që ju nuk e muarët në shqyrtim. Është shumë thelbësore për këtë proces që nga ana e komisionit të vendoset dhe të interpretohet drejt pavlefshmëria absolute, sepse vlera e provës e marrë qoftë dhe nga procesi penal ka shumë mundësi për të dalë një e drejtë. Këta numërues kanë qenë shumë korrektë me votën dhe nuk kanë abuzuar dhe për më tepër Komisioneri nuk provoi se këto vota diferencë, cilit subjekt i janë hequr? Cilit kandidat i janë hequr dhe pse i janë shtuar tjetrit? Nuk e provoi këtë, sepse votat janë të barabarta. Për më tepër nuk ka pas as kundërshtime qoftë dhe në procesverbalet e mbajtura në rinumërim, sepse është rinumëruar. Në qoftë se do të kishte një problem të tillë do të ishte mbajtur, sepse është e njejta votë edhe për subjektin, edhe për kandidatin. Është e papranueshme që të mos ketë pas vota vetëm për subjektin Partia Socialiste, sepse aludohet nga tabela që nuk ekzistojnë vota vetëm për subjektin e Partisë Socialiste, por ekzistojnë vota vetëm për kandidatë. Nga pasqyrimi i të gjitha tabelave që KQZ-ja ka bërë në internet, shihen fare qartë nga studimi që kemi bërë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.01.2022*

ne, që ka diferenca. Nuk është asnjëherë e barabartë shuma e votave të vlefshme të Partisë Socialiste me shumën e votave të kandidatëve, sepse ka pas dhe vota jopreferenciale të cilat nuk kanë qenë fletë votimi të pavlefshme, por kanë qenë votuar për më shumë se një kandidat. Përfundimisht, për të mos u zgjatur, kërkoj pranimin e kërkesës.

Z. L. Braho: Faleminderit Avokat, Atëherë KAS-i do të tërhiqet për vendimin, do të riçelim seancën për të shpallur vendimin pas 30 minutash, rreth orës 14:00, faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 14:10

Z. L. Braho: Riçelim seancën e shqyrtimit administrativ për Kërkesën Ankimore nr. 76, dt.31.12.2021. Përpara se të shpallim vendimin, ju bëj me dije për ankuesit dhe administratën e KQZ-së që gjatë shqyrtimit administrativ, on-line e ka ndjekur mbledhjen dhe anëtari Koli Bele, që nuk është i pranishëm këtu, por e ka ndjekur mbledhjen me të cilin u konsultuam dhe për vendimmarrjen. Pra, është dhe ai pjesë e vendimmarrjes së KAS-it në lidhje me këtë kërkesë ankimore. Atëherë KAS-i, pasi u tërhoq në dhomë këshillimi, vendosi:

Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore të subjekteve ankimues.

Shfuqizimin e vendimit nr. 470, dt.03.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vetëm për pjesën e gjetjeve të raportit që ka lidhje me qendrën e votimit nr. 3305/2, që i përket KZAZ-së nr. 65 të Qarkut Berat.

Argumentet do të jenë të detajuara pasi vendimi të zbardhet. Gjithësesi tre janë argumentet kryesore në bazë të të cilave KAS-i mori këtë vendim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve***

Dt.12.01.2022

E para, ka të bëjë me faktin e përfshirjes së kësaj qendre votimi në procesin paszgjedhor. Pra, në procesin e këqyrjes paszgjedhore.

E dyta, ka të bëjë me procedurat e ndjekura nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në lidhje me gjetjet.

Argumenti i tretë, ka të bëjë pikërisht mbi një shpjegim në lidhje me këtë diferencë që ka lindur për numërin e votave për kandidatët.

Këta janë tre argumentet kryesorë ku KAS-i ka mbështetur vendimmarrjen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 5

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU

